

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë, në fakt, kisha ndër mend ta filloja fjalën time në seancë me shqetësimet e banorëve në zonat ku jam deputet, por, meqenëse zoti Balla e përmendi progresraportin dhe tha se zoti Basha nuk e përmendi, mendoj të ndalem këtu. Zoti Basha u tregua i sjellshëm që nuk iu referua progresraportit për korrupsionin, sepse, megjithëse sipas disave ishte “më i miri”, në progresraport thuhet se korrupsioni është i përhapur në çdo qelizë të jetës publike dhe të biznesit dhe është shqetësim shumë serioz. Pra, zoti Basha jua kurseu këtë, por po jua them unë. Sa i përket çështjes së rregullores së komisioneve hetimore, unë e di që jeni në hall të madh, e di që ju ka shqetësuar shumë. Në ato rregullore ne i kemi referuar përvojës 20-vjeçare, ligjit dhe jurisprudencës 20-vjeçare të Gjykatës Kushtetuese. Ju si gjithmonë nxirrni diçka, por unë besoj se çfarëdolloj pengese procedurale të nxirrni në fund të ditës, nuk mund të na pengoni dot që ato gjëra dhe fakte që duam t’i bëjmë publike, do t’i bëjmë publike. Tani do të ndalem te diçka shumë e rëndësishme, që ka të bëjë jo vetëm me qytetarët dhe votuesit e zonave ku unë jam zgjedhur si deputet, por edhe më gjerë. Së pari, dua t’ju them se prej kohësh kemi denoncuar abuzimet që qeveria bën me fatkeqësinë e njerëzve. Tashmë u bënë dy vjet nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019 dhe ende sot e kësaj dite problemet që solli fatkeqësia natyrore, tërmeti, po konkurrohen dhe po tejkalohen nga problemet që qeveria po u sjell këtyre banorëve që u prekën nga tërmeti, gjithmonë duke pasur si justifikim tërmetin. Këto ditë jam takuar me banorët e njësisë 4 dhe 8 në Tiranë dhe të vjen shumë keq kur shikon se deri ku shkon hakmarrja politike, por edhe grykësia për të përfituar nga fatkeqësitë e njerëzve. Pasi i përdorët fondet e tërmetit për të blerë vota, pasi e përdorët frikën e njerëzve se do t’i linit pa shtëpi në këmbim të deformimit të vullnetit të tyre për zgjedhjet e 25 prillit, tani po i përdorni pronat e tyre për të fituar biznesi afër jush. Një shembull tipik është rasti i banorëve në bllokun “Myslym Keta” në njësinë 4. Këta banorë, të cilët kam pasur rastin t’i takoj edhe para disa muajve, por edhe tani, janë nën presion dhe kërcënim për shtëpitë e tyre. Ekspertiza e parë, menjëherë pas tërmetit, nxori se shtëpitë e tyre në pallatin ku jetojnë këta banorë nuk kanë dëmtime serioze në strukturë dhe qëndruan dy vjet brenda, por ka disa muaj që dikush në qeveri ka ndërruar mendje. Pyetja që ata kanë është e thjeshtë: nëse u rrezikohet jeta dhe pallati po u prishet pse i kanë lënë dy vjet brenda? Në fakt, përgjigjen e kësaj pyetjeje e japin vetë banorët e kësaj zone. Ata janë të bindur se qeveria nuk e ka mendjen te jeta e tyre, por, përkundrazi, tani që mbaruan zgjedhjet e ka mendjen edhe te prona e tyre. Ata janë të bindur se dikujt i ka pëlqyer vendi dhe, duke përfituar nga tërmeti do të bëjë ndërtime. Janë të bindur për këtë, sepse në kohën e zgjedhjeve, kur kishin nevojë për votat, deputeti i zonës, ministri Ahmetaj, kishte treguar një projekt, 3D kuptohet, dhe u kishte premtuar se ata do të kenë shtëpitë që kanë, por të ndërtuara të reja nga fillimi. Problemi është se pas zgjedhjeve ai ka humbur, projekti mbase jo, por ata nuk e kanë parë, edhe pse e kanë kërkuar. Nuk janë pak, por janë 90 familje, të cilat presin që ai të mbajë premtimin. Në vend të tij, në fakt, kanë shkuar punonjësit e ujësjellësit, punonjësit e OSHEE- së dhe i kanë kërcënuar banorët me ndërprerje të dritave dhe ujit. Tani kam një pyetje: si mundet që një shtet të shkojë deri aty sa të kërcënojë banorët me trajtim çnjerëzor?

Sepse t'u presësh ujin dhe dritat njerëzve në shtëpitë që i kanë blerë vetë, ku ata banojnë është trajtim çnjerëzor, që edhe në luftë dënohet. Këta banorë, në fakt, janë shumë fisnikë, sepse, edhe në të drejtën e tyre, nuk kërkojnë të përfitojnë, por të marrin çfarë u takon, mbase edhe më pak, sepse nëse pallati u rrezikon jetën atyre dhe familjeve të tyre, kjo del sipas një ekspertimi ku edhe ata kanë një përfaqësues, janë gati t'i lirojnë vetë, por nëse jo, duan të rrinë në shtëpitë që i kanë blerë vetë. Pse blloku i pallateve të "Myslym Keta" duhet të zhvendoset diku tjetër, sepse kështu kanë vendosur, ndërkohë që në këto hapësira ku ky grup pallatesh ndodhet, mund të ndërtohet thujse trefishi i sipërfaqes që është sot? Siç duket asgjë nuk bëhet pa arsye. Banorët e njësisë 8, te zona e Bregut të Lumit, kanë vite që persekutohen nga Bashkia e Tiranës. E them këtë sepse 70% e këtij komuniteti deri në vitin 2013 ishte pajisur me leje legalizimi dhe me kërkesë për pagesë. Këta banorë janë të bindur se ky është pretekst se është zonë në rindërtim pas tërmetit, pasi aty nuk ka banesa të dëmtuara nga tërmeti. Këtë po e bëni për Pal Nikollin, për Gjelina Kocën, Vlash Markun, Genc Gjinin dhe shumë të tjerë. Unë kam një pyetje: meqë këtyre familjeve dhe shumë të tjerëve u keni kërkuar të braktisin shtëpitë e tyre, të cilat dikujt i duhen, ju lutem, më thoni a keni bërë kontratë me to? Kjo situatë duhet të marrë fund. Njerëzit, pas familjes, shtëpinë kanë më të shtrenjtë, por këta duan t'ia grabisin, njësoj siç kanë bërë në zonën e Kombinatit. Sulmet brenda klaneve të qeverisë mund të jenë të egra ndaj njëri-tjetrit, por ama ata bëhen njësh kur vjen fjala për të grabitur pronat e qytetarëve. Ju faleminderit!